



Pranimi / Dorëzuar Punë/Prodato Received/Delivered	27 - 10 3	viti q-rt Year	
Organ /Nësitia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SEDMSHUK	6722/2023		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1267/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti - kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtare, me Vjollca Sinani Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1267/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], me adresë rr. "Ali Zeneli" Mitrovicë, kundër organit të punësimit, Ministria e Punëve të Brendshme- DMZP në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1267/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Lënda i dërgohet Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-MPB-DMZP.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Pedagoge" në SHME "Hasan Prishtina" në Mitrovicë ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6478/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Njoftimit të datës 12.09.2023 të kandidatit fitues i rekomanduar nga Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore e lëshuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB në lidhje me konkursin me numër reference RN00011610 të publikuar më datë 05.05.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje

në ankesë tek MPB-DMZP, ndërsa Këshilli më datë 19.10.2023, me numër protokolli 1267/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga MPB-DMZP, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e bashkangjitura të lëndës, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk është kompetentë të vendosë në lidhje me këtë ankesë, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet se ankuesja është e punësuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Komunën e Mitrovicës në pozitën "Pedagoge e Institucionit" SHML Ekonomike-Profesionale " Hasan Prishtina" në Komunë të Mitrovicës sipas Kontratës së Punës me Nr.Prot: 84 e datës 30.09.2021,ndërsa e njëjta nuk është kandidatë për pozitën e shpallur sipas këtij konkursi për faktin se nuk kishte konkuruar, rrethanë e konfirmuar edhe nga vetë ankuesja në përmbajtje të kësaj ankese.

Kolegji i Këshillit me rastin e vendimmarrjes, nga shkresat e lëndës dhe bazuar në kontratën e punës të specifikuar më lartë konstaton se kjo pozitë hyn në kategori të nëpunësve të shërbimit publik rrjedhimisht lidhur me statusin e marrëdhënies së punës së ankuses, Kolegji i Këshillit i' u referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë(Ligj i cili është aplikuar në këtë periudhë në tekstin në vijim Ligj i aplikuar..) përkatësisht me nenin 2 paragrafi 2 është përcaktuar se: "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa në nenin 2 paragrafi 4 po të këtij ligji është përcaktuar se : Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me faktin se konstaton jokompetencën në këtë lëndë përkatësisht ankesë dhe ndërlidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësve të shërbimit publik ju referua Ligjit të aplikuar Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 24 paragrafi 4,ku parashihet: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente" dhe nenit 74 të po të njëjtit ligj ku shprehimisht parashihet:"1.Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit.2.Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3.Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet:3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik;3.2.në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3.në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik nëkompetencë të komunës. 5.Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merrpërgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente".



Andaj bazuar në këtë që u tha si më lartë dhe duke marrë për bazë mënyrën e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë, lënda i dërgohet Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-MPB-DMZP me qenë se i udhëheq procedurat në lidhje me këtë konkurs me qëllim që ky organ të bartë këtë lëndë në organin kompetentë që merret me objektin e kësaj ankese.

Andaj, duke ju referuar dispozitave të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, andaj bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1267/2023, datë 27/10/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-MPB-DMZP dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.